

**AKT THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ALLMETA 02.CO sh.p.k.**

**MAKSUT ALLMETA**, lindur ne date 20.05.1957 ne Bexulle, Tirane, i pajisur me dokument identifikimi,  
Karte ID Nr.personal F70520203C, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

I cili ne mbeshtetje te Ligiit nr.9901 date 14.042008 deklaron ne kete Akt themelimi si me poshte:

**NENI 1**

Ortaket e kesaj shoqerie kane vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e cila emertohet **"ALLMETA 02.CO sh.p.k.**

**NENI 2**

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar eshte person juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar  
ne fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave te statutit te kesaj shoqerie dhe duke u  
bazuar edhe ne kete akt themelimi si dy akte baze te kesaj shoqerie.

**NENI 3**

Qendra e kesaj **Shoqerie do te jete ne Tirane, Zall Herr, Komuna Zall Herr, Nr.13, Prane Forcave Komando, impiant inertesh Nr.1/IO**, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj si edhe  
per te hapur dege dhe filiale te tjera ne te gjitha Republikën e Shqiperise si edhe jashte Saj  
ne  
perputhje me legjislacionin Shqiptar.

**NENI 4**

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te jete i perbere nga nje shume prej 100 000 (njqind mije)  
Leke, i cili **eshte shlyer teresisht**, dhe perben kontributin 100% te ortakut te kesaj shoqerie.



## NENI 5

Kohezgjatja e aktivitetit të kesaj shoqërie do të jete me afat të pacaktuar, por shoqëria mund të zgjase apo pakesoje kete afat me vendim të themeluesit të saj. Kjo shoqëri mund të shperbehet sipas rasteve të parashikuara në statutin e kesaj shoqërie (shperberja dhe likuidimi).

## NENI 6

Objekti i aktivitetit të kesaj shoqërie është pacaktuar me hollësi në nenin 4 të statutit të kesaj shoqërie. Kështu konkretisht kjo shoqëri do të ushtroje aktivitetin e saj në:

- \* Tregëtim artikuj të ndryshëm industriale.
- \* Tregëtim automjeteve të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to.
- \* Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit.
  
- \* Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme. Prishje dhe punime në toke të germuar.
- \* Ndertime civile, industriale, turistike, bujqësore deri në 5 kate.
- \* Ndertime civile, industriale, turistike, bujqësore mbi 5 kate. Rikonstruksione.
- \* Punime të mirembajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndertim mbi shtresa rrugore.
- \* Ndertim ujësjelles kanalizime, kanale e impiante vaditese.
- \* Punime mbrojtjeje të sistemit hidraulik, cimentime etj. Sillose, kulla, kulla uji etj, b/arme, metalike.
- \* Perforcime themeli e punime nëntokesore. Izolime mbi dhe nëntokesore nga ujrat.
- \* Themele të vecanta,
- \* Punime karpenterie druri e metalike.
- \* Instalimi i materialeve prej druri, metalike, plastike, Xhami etj.
- \* Punime bojatisje, hidroizolimi, termoizolimi, akustike. kundër zjarrit.
- \* Ndertim objektesh të permasave të ndryshme, shtëpi, vila, ndërtesa shumëkateshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje, shërbim fasade.
- \* Ndertim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.
- \* Ndertim digash, galeri, tunele. Ndertim vepra kullitni, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sisteme elektrike.
- \* Ndertim ambiente dhe sisteme gjelberimi, parqe e lulishte

**Si edhe cdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kesaj shoqërie në përputhje me legjislacionin shqiptar.**

## NENI 7

Fillimin e aktivitetit të saj tregëtar kjo shoqëri e lidh me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar të Q.K.B si edhe me pajisjen me licencën përkatëse nga Zyra e Tatimeve.

## NENI 8



Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

#### **NENI 9**

Administrator i kesaj shoqerie per pese vitet e para me te drejte rizgjedhjeje do te jete MAKSUT ALLMETA, i cili ushtron edhe ndjek aktivitetin e shoqerise, duke zbatuar edhe kompetencat perkatese sipas dipsozites perkatese te statutit.

#### **NENI 10**

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te Saj te luajtshme dhe te paluajtshme kjo shoqeri mund t'i drejtohet Agjensive te Sigurimit ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 11**

Dispozita me te hollesishme jane parashtruar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesit. Ortakut pasi i lexohet akti i mesiperm e eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote e firmos rregullisht para meje noterese e une noterja e vertetjoj sipas Ligiit.

#### **SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**ALLMETA 02.CO sh.p.k.**

**ORTAKU I VETEM**

*Maksut Allmeta*

*27/08/21*

*Dt. 27.08.2021*

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ALLMETA 02.CO" sh.p.k.**

**KREU 1**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**ALLMETA 02.CO**" sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", nga ortaku i Vetem MAKSUT ALLMETA , lindur ne date 20.05.1957 ne Bexhulle, Tirane, i pajisur me dokument identifikimi, Karte ID Nr. Personal F70520203C, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**NENI 2**

Shoqeria "**ALLMETA 02.CO**" sh.p.k e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dipsozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (Akti i themelimit dhe Statuti i shoqerise).

Shoqeria "**ALLMETA 02.CO**" sh.p.k. eshte person juridik.

Ajo e fiton kete te drejte si person juridik nga data e regjistrimit te kesaj shoqerie ne regjistrin tregtar te Q.K.B, Tirane. Qendra e kesaj shoqerie do te jete ne adresen Tirane, Zall Herr, Komuna Zall Herr, Nr.13, Prane Forcave Komando, impiant inertesh Nr.1/10.

**NENI 3**

Shoqeria "**ALLMETA 02.CO**" shp.k. krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar, por shoqeria mund te zgjase kete afat edhe me tej me vendim te themeluesve te saj. Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e saj te veprimtarise se saj ose mund te mbylle aktivitetin e saj edhe para mbarimit te ketij afati, e realizuar kjo sipas dipsozitive qe percaktohen ne kete statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve dhe sipas kriterëve qe percaktohen ne legjislacionin ne fuqi.

**NENI 4**

Shoqeria "**ALLMETA 02.CO**" shp.k. per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te



tretet pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurite e tyre qe nuk jane futur ne kapitalin e kesaj shoqerie. Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

### **NENI 5**

Objekti i aktivitetit te kesaj shoqerie eshte percaktuar me hollesi ne nenin 4 te statutit te kesaj

shoqerie. Keshtu konkretisht kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne:

- \* Tregetim artikuj te ndryshem industriale.
- \*Tregetim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- \*Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.
  
- \*Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme. Prishje dhe punime ne toke te germuar.
- \*Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 Kate.
- \*Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore mbi 5 kate. Rikonstruksione.
- \*Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore.
- \*Ndertim ujesjelles kanalizime, kanale e impiante vaditese.
- \*Punime mbrojtjeje te sistemit hidraulik, cimentime etj. Sillose, kulla, kulla uji etj, b/arme, metalike.
- \*Perforcime themeli e punime nentokesore. Izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat.
- \*Themele te vecanta,
- \*Punime karpenterie druri e metalike.
- \*Instalimi i materialeve prej druri, metalike, plastike, Xhami etj.
- \*Punime bojatisje, hidroizolimi, termoizolimi, akustike. kundra zjarrit.
- \*Ndertim objektesh te permasave te ndryshme,shtepi,, vila, ndertesa shumekateshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje, sherbim fasade.
- \*Ndertim rrugeshe dhe urash si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.
- \*Ndertim digash, galeri, tunele. Ndertim vepra kullitni, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sistemime elektrike.
- \*Ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte.

**Si edhe cdo veprimtari tjetër që i sherben rritjes dhe zhvillimit te kesaj shoqerie ne perputhje me legjislacionin shqiptar.**



## KAPITALI THEMELTAR

### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 Leke, vetem 1 kuote, e zoteruar teresisht nga ortaku I vetem. Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme nga ortaket e kesaj

shoqerie perkundrejt personave te trete si edhe ne rruge trashegimie. Kapitali i kesaj shoqerie mund te shtohet ose pakesohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar ne natyre behen me miratimin e ortakeve. Vleresimi i ketij kapitali behet nga ortaket e shoqerise dhe me vendim te Asamblese se Ortakeve dhe nga nje ekspert kontabel i caktuar nga vete Ortaket.

### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 Leke, vetem 1 kuote, e zoteruar teresisht nga ortaku I vetem. Zmadhimi ose zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga Ortaket. Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te Ortakeve te cilet do te percaktojne formalitete per pranimin e pjesmarresve te rinj, Ortaku qe zoteron kapitalin, pjeset e tij eshte i detyruar te lajmeroje me shkrim shoqerine dhe secilin ortak. Nese shoqeria nuk e miraton kete transferim brenda tre muajve te bleje pjeset e kapitalit ai vete, nese eshte bere vleresimi i tyre nga eksperti. Me kalimin e ketij afati miratimi konsiderohet i dhene Per cdo pjesmarres te ri qe do te pranohet, shoqeria jep nga nje vertetim per numrin e kuotave qe zoteron dhe vleren nominale te tyre. Ne asnje rast ortaku nuk mund te detyroje ortakun tjetere qe te shtoje detyrimet ne kapitalin fillestar. Shtimi i kuotave te kapitalit mund te behet edhe ne mall ose ne natyre. Per kete behet me pare vleresimi i ekspertit te autorizuar. Pakesimi i kapitalit mund te behet nese motivohet per demet qe peson shoqeria, deme te cilat nuk mbulohen nga kapitali rezerve dhe neqoftese ne raprtin e vleresimit te ekspertit kontabel rezultoj qe kapitali fillestar per shkak te demeve eshte me i vogel se e ortaket brenda kater ditesh nga miratimi i llogarive qe paraqiten per mundesine e shperberjes se parakohshme te shoqerise. Ne rast se kuotat e kapitait te shoqerise transferohen ne favor te nje personi te trete, ai merr automatikisht te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka ortaku qe dorezon kuotat, pra qe largohet, perfshi edhe ato lloj detyrimesh qe ortaku shites ka marre mbi vehte duke firmosur kontraten per themelirnin e shoqerise, kete ai duhet ta pranoje duke iu dhene konfirmimi me shkrim ortakeve te te shoqerise. Ne nuk do te behet ky konfirmim me shkrim, shitja e kuotave nje personi te trete do te konsiderohet e pavlefshme. Shoqetua zhvillon aktivitetin e saj ne baze te nje pavaresie ekonomike. Ajo nuk pranon asnje nderhyrje nga organet shtetere apo publike te cfaredo lloji qofshin, perjashtuar kontrollit qe ka drejte te bejne organet shtetere ne baze te ligjit ne fuqi.



## **KREU 11**

### **ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 8**

Organet e shoqerise jane :

Asambleja e Ortakve,

Administratori.

#### **NENI 9**

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Ajo vendos per : Bilancin vjetor

Ndryshimet ne statut.

Shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar.

Emerime dhe shkarkime te administratorit.

Emerimin e ekspertit kontabel

Hapjen e degeve apo filialeve apo perfaqesive te saj.

Shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter te saj.

Zgjatja e afatit te aktivitetit te saj.

Marrjen dhe largimin nga puna te drejtorit te pergjithshem

Vendime per marrjen pjese ne shoqeri te tjera

Aprovimin e rregullores se shoqerise

Kalimin e shoqerise ne likujdim si edhe te mbylljes se bilancit jashte likujdimit.

Kuvendi i aksioneve do aprovoje nje akt te brendshem me te cilin do rregulloje menyren e organizimit, kontrollit te brendshem, prokuren dhe cdo procedure tjeter te administrimit te shoqerise.

#### **NENI 10**

Asambleja e zakonshme e Ortakeve realizohet me lajmerimin e tyre me leter-rekomande qe u

drejtohet ortakeve nga administratori ose eksperti kontabel 15 dite perpara duke percaktuar edhe rendin e dites. Ortaket, Vendimet e marra ne mbledhjet e zakonshme ne perputhje me kete statut jane te detyrueshme dhe te zbatueshme per te githe. Asambleja e Ortakeve te vetem behet te pakten nje here ne vit. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te punoje, drejtoje dhe te organizoje shoqerine ne menyre qe te siguroje suksesin ekonomik financiar te veprimtrise se shoqerise. Te zbatoje vendimet qe marrin ortaket qe i jepen ne kuader te kompetencave qe i cakton ky statut ose ne baze te legjislacionit ne fuqi, Te paraqese raportin e administratorit, te inventareve, bilancin dhe llogarite vjetore ortakeve brenda gjashtemujorit te pare nga mbyllja e vitit financiar.

#### **NENI 11**



Ortaket kane te drejte te marrin pjese ne aktivitetin e shoqerise ne menyre e percaktuar ne akt themelimin dhe ne statutin e shoqerise, te marre nje pjese te fitimeve te aktivitetit te Shoqerise, te marre informacion mbi aktivitetin e shoqerise pa asnje pengese, Ka te drejte te beje kontrollin e librave te shoqerise me ane te nje kontrolli te specializuar, ne kete rast me shpenzimet e veta te marre pjese nga pasuria e shoqerise qe do te rezultojne si aktiv ne bilancin e likujdimit te shoqerise. Ortaket kane te drejte qe te transferojne lirisht jashte shtetit ne valuten qe deshiron, ate pjese fitimi qe i takon. Po keshtu edhe kundravleren e kuotave te kapitalit qe eventualisht mund te shese, apo vleften qe i perket asaj ne rast se shoqeria do te likujdohet.

#### **NENI 12**

Administrator i kesaj shoqerie per pese vitet e para me te drejte riperseritje do te jete Z. MAKSUT ALLMETA, i cili kryen veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise ose me prokure te pergjithshme me ane te se ciles i delegon kompetencat ndonje personi te trete. Ne marredheniet me te tretet Ortaket kane te tjitha kompetencat per te kryer veprimet ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise. Ortaket jane pergjegjee individualisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete kur gjate veprimeve te tij shkelet ligji, akti i themelimit dhe statuti i shoqerise ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit do te percaktohen ne nje akt te brendshem.

#### **NENI 13**

Marredheniet e punes me te punesuarit prane shoqerise rregullohen me kontrate individuale qe do te lidhen me secilin prej tyre ne baze te ligjeve ne fuqi dhe kodit te punes.

#### **NENI 14**

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i cili emerohet nga Ortaku i Vetem i Shoqerise **ALLMETA 02.CO** sh.p.k. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset me te njejta kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe e ben te pamundur kryerjen e detyres.

#### **KREU 111**

#### **MARREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE**

#### **NENI 15**

Viti financiar fillon me date 01 Janar dhe mbaron ne date 31 Dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, raportet dhe operacionet e vitit financiar e raportet e vecanta te hartuara nga





Ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve.  
Miratimi i bilanceve mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

#### **NENI 16**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimit, Ortaket percaktojne pjesen e fitimit qe I takon, pasi te jene zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem, ajo pjese qe mbetet nga fitimi pasi te jete zbritur pjesa qe do te kaloje me fondin rezerve, pjesa per fondet e tjera eventuale dhe pasi te jene likjudduar te gjitha detyrimet tatimore, ju perket ortakeve te cilet kane te drejte ta disponoje teresisht.

#### **NENI 17**

Njohurite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi, ne leke ose ne valute te huaj. Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe qe mbeshtet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore me pune e tyre. Shoqeria me qellim qe te lehtesoje punen dhe te beje sa me shpejt pagesat me te tretet do te hape llogari bankare nga bankat qe jane te njohura nga Shteti Shqiptar, vendase ose te huaja.

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

#### **NENI 18**

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vendim te Ortakeve. Ajo prishet kur mbaron afati i percaktuar nga ortaket dhe ortaket nuk kane rene dakort qe te beje riparteritjen e ketij afati. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje nga format e percaktuara dhe te kerkuar nga ligji numer 9901 date 14.04.2008.

#### **NENI 19**

Shoqeria tregtare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Ortaket emerojn nje likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, giendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likujdimit Ortaket vendosin mbi bilancin perfundimtar mbi aktin dhe rregullsine e likujdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te shoqerise.

#### **NENI 20**

Zgjidhja e mosmarreveshjeve ndermjet ortakut apo ortakeve te futur ne kete shoqeri eshte



percaktuar ne aktin e themelimit te shoqerise. Mosmarveshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe te treteve lidhur me marredheniet kontraktuale qe shoqeria do te kete duhet t'i perfshije ne secilen nga kontratat qe do te lidhe.

#### **NENI 21**

Ky Statut formulohet ne 4 (kater) kopje me vlere te barabarte, nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise, njera ne Q.K.R, Tirane, njera ne Zyren e tatimeve dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e shoqerise.

#### **SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**" ALLMETA 02.CO " shp.k.**

**ORTAKU I VETEM**

**27/08/2021**

*Maksut Allmeta*  
*[Signature]*